

Emertimi dhe forma juridike

**"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO)"SHPK**

Nipt - i

L31804506A

Adresa e selise

Lagja 13 Porti I Durresit ,Terminali Lindor ,Hyrja nr 5.

DURRES

Data e krijimit

03.06.2013

Nr. I regjistrit tregetar

CN-116922-06-13

Veprimtaria kryesore

Menaxhimi ,operimi ,mirembajtja dhe  
permiresimi teknik dhe adaptimi i Terminalit  
Lindor ne portin e Durres sipas marreveshjes  
koncensionare te lidhur me Qeverine Shqiptare .  
Operimi i Terminalit do te perfshije ,pa u kufizuar  
vetem ne to ,ngarkimin dhe shkarkimin kryesisht te  
anijeve me ngarkesa rifuxho si ato te mineraleve  
dhe qymyrit dhe te materialeve te tjera rifuxho por  
edhe te anijeve me ngarkesa te pergjithshme ,etj .

## PASQYRAT FINANCIARE

Baza Ligjore : Ligji nr 25 dt 10,05,2018 per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare

Periudha Raportuese

01.01.2019

deri

31.12.2019

Pasqyrat financiare jane :

Individuale

Pasqyrat financiare jane te shprehura ne

Lekë

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

10.03.2020

Hartuesi

Edlira Buzani

Per Drejtimin e Njesisë Ekonomike

Manfred Müller



" EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO) "

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci ) 2019

Nr	A K T I V E T	Shenime	P e r i u d h a	
			Raportuese/19	Paraardhese/18
<b>I</b>	<b>Aktivitet Afatshkurtra ( I )</b>		<b>97,492,115</b>	<b>87,277,968</b>
<b>1-</b>	<b>Aktivitet monetare</b>	1	<b>10,702,131</b>	<b>9,566,058</b>
	(i) Banka		10,590,664	9,400,795
	(ii) Arka		111,467	165,263
<b>2-</b>	<b>Investime</b>	2		
	(i) Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit			
	(ii) Aksionet e veta			
	(iii) Te tjera financiare			
<b>3-</b>	<b>Te drejta te arketueshme</b>	3	<b>71,347,155</b>	<b>65,711,885</b>
	(i) Nga aktiviteti I shfrytezimit		32,531,913	31,369,503
	(ii) Nga njesite ekonomike brenda grupit			
	(iii) Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjese-marrese			
	(iv) Te tjera te drejta te arketueshme		38,815,241	34,342,382
	(iv) Kapitali I nenshkruar I papaguar			
<b>4</b>	<b>Inventaret</b>	4	<b>8,896,713</b>	<b>6,300,792</b>
	(i) Lendet e para dhe materialet e konsumueshme			
	(ii) Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte			
	(iii) Produkte te gatshme			
	(iv) Mallra		-	995,130
	(v) Te tjera gjendje inventari		8,896,713	5,305,661
	(vi) Parapagesa per furnizime		-	-
<b>5</b>	<b>Aktive biologjike afatshkurtra</b>	5		
<b>6</b>	<b>Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje</b>	6		
<b>7</b>	<b>Shpenzime te shtyra</b>	7	<b>6,546,115</b>	<b>5,699,233</b>
	(i) Shpenzime te periudhave te ardhshme		6,546,115	5,699,233
<b>8</b>	<b>Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara</b>	8		
<b>II</b>	<b>Aktivitet Afatgjata (II)</b>		<b>540,507,650</b>	<b>594,731,822</b>
<b>1</b>	<b>Aktivitet financiare afatgjata</b>	9	3,044,250	30,855,000
<b>2</b>	<b>Aktive afatgjata materiale</b>	10	529,563,454	555,976,876
	(i) Toka			
	(ii) Konteniere ( zyra )		21,728,847	22,872,471
	(iii) Makineri dhe pajisje		437,578,249	474,283,328
	(iv) Te tjera instalime dhe pajisje		57,092,777	58,821,078
	(VI) Parapagime per aktive materiale		13,163,581	
<b>3</b>	<b>Aktivitet biologjike afatgjata</b>	11		
<b>4</b>	<b>Aktivitet afatgjata jo materiale</b>	12		
	(i) Emri i mire			
	(ii) Shpenzimet e zhvillimit			
	(iii) Aktive te tjera afatgjata jomateriale			
<b>5</b>	<b>Kapitali aksioner i pa paguar</b>	13		
<b>6</b>	<b>Aktive te tjera afatgjata (investime ne proces )</b>	14	7,899,946	7,899,946
	<b>TOTALI I AKTIVEVE I +II</b>		<b>637,999,765</b>	<b>682,009,789</b>

" EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO) "

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci ) 2019

Nr	Detyrimet dhe Kapitali	Shenime	P e r i u d h a	
			Raportuese/19	Paraardhese/18
<b>I</b>	<b>Detyrimet Afatshkurtra (I)</b>		<b>186,179,379</b>	<b>240,655,833</b>
1-	Titujt e huamarrjes	15		
2-	Detyrimet ndaj institucioneve te kredise	16	90,711,231	92,352,028
	(i) Overdraftet Bankare		90,711,231	92,352,028
	(ii) Huamarrje afatshkurtra			
3-	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	17	95,468,148	148,303,805
	(i) Te pagueshme ndaj furnitoreve		90,212,273	142,792,727
	(ii) Te pagueshme ndaj punonjesve		2,545,680	2,208,466
	(iii) Detyrime tatimore		2,693,095	3,302,612
	* Detyrimet per sig shoqerore e shendetsores		1,230,022	1,395,116
	* Detyrimet tatimore per Tap-in		474,191	705,105
	* Detyrimet tatimore per TVSH		-	-
	* Detyrimet per Tatimin mbi Fitimin		-	-
	* Detyrimet tatimore per tatimin ne burim		988,882	1,202,391
	* Te tjera detyrime tatimore		-	-
	(iv) Te tjera te pagueshme		-	-
	(v) Arketime ne avance per porosi		17,100	-
4-	Te pagueshme per shpenzimet e konstatuara	18		
5-	Te ardhurat e shtyra	19		
6-	Provizionet afatshkurtra	20		
<b>II</b>	<b>Detyrimet Afatgjata (II)</b>		<b>284,960,496</b>	<b>324,029,925</b>
1-	Titujt e huamarrjes	21	1,888,664	3,076,215
	(i) Hua, bono dhe detyrime nga qetaja financiare		1,888,664	3,076,215
2-	Huamarrje te tjera afatgjata	22	283,071,833	320,953,710
3-	Te ardhura te shtyra	23		
4-	Provizionet afatgjata	24		
5-	Detyrimet tatimore te shtyra	25		
	<b>Totali Detyrimeve ( I + II )</b>		<b>471,139,875</b>	<b>564,685,758</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali III</b>		<b>166,859,890</b>	<b>117,324,030</b>
1-	Kapitali dhe rezervat	26		
2-	Kapitali I nenshkruar	27	100,000	100,000
3-	Primi I lidhur me kapitalin	28		
4-	Rezerva rivleresimi	29		
5-	Rezerva te tjera	30	117,214,030	116,222,924
5.1	Rezervat statuore	31		
5.2	Rezervat ligjore	32	10,000	10,000
5.3	Rezervat e tjera	33		
6-	Fitimi I pashperndare	34	-	-
10-	Fitim (Humbja) e vitit financiar	35	49,535,859	991,107
	<b>Totali I Detyrimeve dhe Kapitalit ( I + II + III )</b>		<b>637,999,765</b>	<b>682,009,789</b>

**" EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO)"**

**Pasqyra e performances 2019**

( Pasqyra e teArdhurave dhe Shpenzimeve )

( Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas Natyres)

Nr	Perskrimi i Elementeve	Shenime	P e r i u d h a	
			Raportuese/19	Paraardhese/18
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	1	565,229,418	492,577,728
2	Te ardhura te tjera nga aktiviteti i shfrytezimit	2	254,312	-
3	Ndryshime ne inventarin e produkteve te gatshme te prodhimit ne proces	3		
4	Puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	4		
5	Lenda e pare dhe materiale te konsumeshme	5	-112,924,178	-110,625,030
6	Shpenzime te tjera nga aktiviteti i shfrytezimit	6	-243,446,246	-246,566,542
	- Te tjera shpenzime shfrytezimi		-232,038,772	-236,880,817
	- Tatim taksa		-11,407,474	-9,685,725
7	Shpenzime te personelit	7	-89,205,449	-97,740,563
	- Pagat e personelit		-79,237,201	-86,463,742
	- Shpenzimet per sigurimet shoqerore e shendetesore		-9,968,248	-11,276,821
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	-42,941,258	-47,718,919
<b>9</b>	<b>Totali i Shpenzimeve ( shumat 4 deri 7)</b>		<b>-488,517,131</b>	<b>-502,651,054</b>
<b>10</b>	<b>Fitimi(humbja) nga aktiviteti i shfrytezimit (1+2+/-3-8)</b>		<b>76,966,599</b>	<b>-10,073,326</b>
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara	9		
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet	10		
13	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	11		
	13.1 Te ardhurat e shpenzimet financiare nga investimet, te tjera financiare afatgjata	12		
	13.2. Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	13	-23,555,465	-25,629,885
	13.3. Fitimet(Humbjet) nga kursi i kembimit	14	5,497,828	36,612,333
	13.4. Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	15	906,829	2,832,577
<b>14</b>	<b>Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare (12.1+12.2+12.3+12.4)</b>		<b>-17,150,809</b>	<b>13,815,024</b>
<b>15</b>	<b>Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)</b>	<b>16</b>	<b>59,815,790</b>	<b>3,741,698</b>
<b>16</b>	<b>Shpenzimet e tatimit mbi fitimin</b>	<b>17</b>	<b>10,279,931</b>	<b>2,750,592</b>
	i)Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		10,279,931	2,750,592
	ii)Shpenzimi i tatimi fitimit te shtyre			
<b>17</b>	<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14 - 15)</b>	<b>18</b>	<b>49,535,859</b>	<b>991,107</b>

" EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO) " Pasqyra e teArdhurave Gjithepershires te vitit 2019

( pjese e Pasqyres se Performances )

Nr	Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	Shenime	P e r i u d h a	
			Raportuese/19	Paraardhese/19
Nr	Pershkrimi i Elementeve			
▶	Fitimi/Humbja e vitit		49,535,859	991,107
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-	-
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivitet financiarë të mbajtura për shitje		-	-
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-	-
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		49,535,859	991,107
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		-	-
	<i>Pronarët e njësisë ekonomike mëmë</i>			
	<i>Interesat jo-kontrolluese</i>			

Nr	Pasqyra e Fluksit monetar (Metoda indirekte)	shenime	P e r i u d h a	
			Raportuese/19	Paraardhese/18
1-	<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>			
	Fitimi /Humbja e vitit	1	49,535,859	991,107
	<b>Rregullime per shpenzime jo monetare :</b>			
	Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi	2	42,941,258	47,718,919
	Zhveleresimi I aktive afatgjat materiale			
	<b>Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit :</b>			
	Rritje/renie ne tepricen Llogari/Te drejta te arketueshme si dhe I te drejtave te tjera te arketueshme	3	21,328,598	10,935,880
	Rritje/renie ne tepricen e inventarit	4 -	2,595,922	769,388
	Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve per tu paguar nga aktiviteti	5 -	54,476,455	47,490,159
	<b>Mjete monetare neto nga (perdoruar ) ne aktivitetin e shfrytezimit</b>		<b>56,733,339</b>	<b>107,905,453</b>
	<b>MM neto nga Aktiviteti I Shfrytezimit</b>		<b>56,733,339</b>	<b>107,905,453</b>
	<b>Mjete monetare neto nga (perdorur ne ) aktivitetin e investimit</b>			
	Para neto te perdoruara per blerjen e filialeve			
	Para neto te arketuara nga shitja e filialeve			
	Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	6 -	16,774,088	12,923,010
	Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	7	246,252	264,253
	Arketime nga shitja e investimeve te tjera			
	Dividentet e arketuar			
	<b>Mjete Monetare neto nga (perdorur ne )aktivitetet investuese</b>		<b>- 16,527,836</b>	<b>- 12,658,757</b>
	<b>Fluksi I mjeteve monetare nga (perdoruar ne ) veprimtarite e financimit</b>			
	Arketime nga emetimi I kapitalit aksionar			
	Hua te arketuara	8 -	39,069,429	95,847,604
	Rritje/Pakesime detyrimeve te qirase financiare			
	Dividentet e pagueshem			
	<b>Mjete Monetare neto e perdorur ne aktivitetin e financimit</b>		<b>- 39,069,429</b>	<b>- 95,847,604</b>
	<b>Rritja/renia neto e mjeteve monetare</b>		<b>1,136,074</b>	<b>- 600,908</b>
	<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim te periudhes rap</b>		<b>9,566,058</b>	<b>10,166,964</b>
	<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund te periudhes rap</b>		<b>10,702,131</b>	<b>9,566,058</b>

" EMS ALBANIAN PORT OPERATOR (EMS APO) " SHPK

Pasqyra e ndryshimeve ne Kapitalin Neto Periudha 01-Janar - 31 Dhjetor 2019

(Pasqyre Individuale)

	Kapitali I nenshkruar	Primi I lidhur me kapitalin	Rezerva rivleresimi	Rezerva ligjore	Rezerva statutore	Rezerva te fjera	Fitimet e pashperdara	Fitim /Humbja e vitit		TOTALI
<b>Pozicioni financiar me 01/01/2018</b>	100,000	-	-	-	-	60,688,926	-	55,543,998		116,332,924
<i>Efekt i ndryshimit ne politikat kontabël</i>										-
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar 01.01.2018</b>										-
<i>Te ardhura totale gjithpershirese per vitin</i>										-
<b>Fitim /Humbja e vitit (2018)</b>								991,107		991,107
<i>Te ardhura te fjera gjithpershirese per vitin</i>										-
<i>Emetimi i kapitali aksionar</i>										-
<i>Transferime ne rezerven e deqyreshme ligjore</i>				10,000				10,000		-
<i>Transferime ne rezerven e deqyreshme statutore</i>										-
<i>Transferime ne rezerva te fjera</i>						55,533,998		55,533,998		-
<i>Dividentet e paguar</i>										-
<b>Pozicioni me 31.12.2018</b>	100,000	-	-	10,000	-	116,222,924	-	991,107		117,324,030
<b>Fitim /Humbja e vitit (2019)</b>								49,535,859		49,535,859
<i>Dividentet e paguar /deklaruar</i>										-
<i>Emetimi i kapitali aksionar</i>										-
<i>Transferime ne rezerven e deqyreshme ligjore</i>										-
<i>Transferime ne rezerven e deqyreshme statutore</i>										-
<i>Transferime ne rezerva te fjera</i>						991,107		991,107		-
<b>Pozicioni financiar me 31.12.2019</b>	100,000	-	-	10,000	-	117,214,030	-	49,535,860		166,859,890

*"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*  
*Shenime per Deklarimet Financiare*  
*Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

---

**1. Organizimi, Objekti dhe Kontributet, Pronesia mbi aktivet,  
Kapitali dhe Administrimi**

**Organizimi**

Shoqeria "EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " shpk eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne date 03.06.2013.

Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, (i ndryshuar )nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

**Objekti dhe Kontributet**

Menaxhimi, operimi, ndertimi, mirembajtja dhe përmirësimi teknik dhe adaptimi i Terminali Lindor në Portin e Durrësit sipas marrëveshjes koncensionare të lidhur me Qeverinë Shqiptare. Operimi i Terminalit do të përfshijë, pa u kufizuar vetëm në to, ngarkimin dhe shkarkimin kryesisht të anijeve me ngarkesa rifuxho si ato të mineraleve dhe qymyrit dhe të materialeve të tjera rifuxho, por edhe në anijeve me ngarkesa të përgjithshme/gjenerale dhe për ngarkesa për projekte, sipas rastit. Shërbimet që do të ofrohen do të përfshijnë gjithashtu edhe aktivitetet e lidhura me to, me anijet dhe ngarkesa, të tilla si përpunimi i ngarkesave, lëvizja e ngarkesave në anije dhe lidhja e tyre, depozitimi dhe magazinimin e ngarkesave, assemblimin e mallrave, mbushja dhe zbrazja e konteinerëve, lëvizje ekstra dhe sistemime transportin, spontimi, marrjen dhe shpërndarjen.

Kontributi ne shoqeri perfaqesohet nga kapitali i ortakut te vetem :  
EMS SHIPPING & TRADING si me poshte:

Ortakët	% ne Kapital	Kapitali
EMS SHIPPING & TRADING	100	100 000
TOTALI	100	100,000

**Kapitali**

Kapitali i shoqerise prej 100,000 leke eshte kapitali i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Bisneseve (QKB ) Numuri i pjeseve ne kapital eshte nje .

**Administrimi**

Shoqeria drejtohet nga nga Administratori. Atij i perkasin te gjitha kompetencat per drejtimin ekzekutiv te pergjithshem. Administrator i shoqerise eshte Z. Manfred Muller

**2.Zbatimi i rregullave te mbajtjes se kontabilitetit**



# *"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*

## *Shenime per Deklarimet Financiare*

### *Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kërkesat e ligjit nr 25 dt.10.05.2018 "Per Kontabilitetin Pasqyrat Financiare". Veprimet janë regjistruar në menyre kronologjike. Çdo veprim është mbështetur në dokumenta justifikuese. Veprimet janë ngurtesuar me 31 dhjetor 2019.

### **3. Politikat kryesore kontabile**

#### **3.1 Bazat e pergatitjes**

Deklarimet financiare të bashkangjitura janë pergatitur në baze të rregjistrimeve kontabel të mbajtura për qëllime të kontabilitetit të vendit konform Ligjit 25 date 10 Maj 2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare të fund vitit janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Kombetare të Kontabilitetit në fuqi ( SKK 2).

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklaratimet financiare janë pergatitur mbi bazen e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SKK-ve , kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rendesishme. Kjo gjithashtu kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rendesishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shenime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjten periudhë kontabel si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen në menyre të kompjuterizuar, me anë të programi të kontabilitetit Alpha Bisness .

Deklarimet financiare janë shprehur në Leke, e cila është monedha funksionale.

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabel mbi bazen e të cilave janë pergatitur deklaratimet financiare janë paraqitur sa më poshtë:

#### **3.2 Instrumentat financiare**

Kompania ka vetëm instrumenta financiare jo derivative, përfshirë dhe kërkesa nga kliente dhe kërkesa të tjera, mjete likuide dhe të ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe të tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vlerën e drejte plus, çdo kosto të drejtperdrejte transaksioni të lidhura me to, përveç atyre të përshkruara më poshtë. Në vazhdim të njohjes fillestare instrumentat financiare vlerësohen si më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse kompania është pale në kushtet e kontratës. Aktivët financiare nuk njihen nëse të drejtat e Kompanisë mbi rrjedhjet e ardhshme të parase të gjeneruara nga aktivi financiar kanë mbaruar ose nëse kompania i transferon aktivët financiare një pale të tretë pa mbajtur të drejtat e kontrollit ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet në datën e shitblerjes psh. datën në të cilën kompania vendos vete të blejë apo të shesë aktivët. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Kompanisë e specifikuar në kontratë mbarojnë afatin ose shlyen ose anulohen.

##### **1.1.1 Mjetet Monetare**

## *"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*

### *Shenime per Deklarimet Financiare*

#### *Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfitimi parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

#### ***1.3.3 Kerkesa per t'u arketuar***

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

#### ***1.3.17 Detyrime te pagueshme***

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

#### ***II.2.22 Huate bankare dhe te tjera***

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

#### ***Te tjera***

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metodet e interest efektiv, minus cdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 3.9 dhe 3.10.

Aktivet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

### **3.3 Inventaret**

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vleres neto qe njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten embylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore te objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

### **3.4 Aktivet Afatgjata Materiale**

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit eshte mbi bazen e metodes zbritese.

Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

### **3.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale**

Shoqeria nuk zoteron Aktive Afatgjata Jo Materiale

# *"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*

## *Shenime per Deklarimet Financiare*

*Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

### **3.6 Kuotat e kapitalit**

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuota njihet me vleren nominale 100 mije leke.

### **3.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare**

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te Kompanise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tille atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e nje aktiviteti eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktiviteti eshte me e madhe mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normene skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivitetit.

Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe do te ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

### **3.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare**

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e flukseve te ardhshme te parase prej atij aktiviteti.

Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktiviteti financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel (neto) dhe vleres aktuale te flukseve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjetere e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anulohet nese ajo mund te lidhet objektivist me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anulimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje

### **3.9 Njohja e te ardhurave**

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vleren e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te Kompanise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

## *"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*

### *Shenime per Deklarimet Financiare*

#### *Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i probesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

#### **3.10 Shpenzimet**

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet ne bazë të këtij parimi regjistrohen në periudhën në të cilën ato ndodhin pavarësisht nëse është paguar ose jo.

#### **3.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

#### **3.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre**

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore qe percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njih aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

#### **3.13 Transaksionet me monedhat e huaja**

##### *(a) Monedha e perdorur dhe raportuese*

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

##### *(b) Transaksionet dhe Gjendjet*

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe

*"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*

*Shenime per Deklarimet Financiare*

*Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

detyrimet me monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyrat e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42
USD	108.64	107.82

**Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit**

Shumat e kolones "Ushtrim i Mbyllur 2019 " si ne aktiv dhe ne pasiv te cilat kapin shumen 637,999,765 leke.

**I.1.1. Aktivet Afatshkurter**

*Mjetet monetare* perfaqeson vlerat ne banke dhe ne arke si me poshte.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Para ne dore	111.467	165.263
Para ne Banka	10.590.664	9.400.795
<b>Totali</b>	<b><u>10.702.131</u></b>	<b><u>9.566.058</u></b>

Elogadit me valute jane kovertuar me kursin e dates 31.12.2019 ne Banken se Shqiperise 121.77 euro dhe 108.64 USD

*I.3.3 Aktive te tjera afatshkurter financiare* perfaqesojne vleren e klienteve te pa arketuar, tatim fitimi dhe vleren e TVSH-se te mbipaguar.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kerkesa te arketueshme	32.531.913	31.369.503
Te tjera kerkesa te arketueshme	38.815.243	34.352.382
<b>Totali</b>	<b><u>71.347.157</u></b>	<b><u>65.711.885</u></b>

Klientet detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
1-SMB Group	354.508	2.338
2-Aris Albania	98.760	87.320
3-Klosi shpk	375.400	66.660
4-Alb-Canaj	166.920	13.920

*"EMS ALBANIAN PORT OPERATOR EMS APO " Shpk*  
*Shenime per Deklarimet Financiare*  
*Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019*

5-Antea Cement	5.419.653	3.508.927
6-Kurum International	3.861.264	146.286
7-German Albania Logistics Agency	20.957	27.911
8-Excellent Control	194.520	293.760
9-Kromex	573.554	569.225
10-Marej	1.608.728	1.599.430
11-Pelikan shpk	7.201.355	3.780.650
12-Miniera e Kromit Katje	72.080	31.480
13-Alb Lea Internartional		391.280
14-Sorige Alb		3.360
